# INFORMATA MBI GRANTIN

| | |
|---|---|
| Instrumenti: | Grant për Zhvillimin Organizativ |
| Subjekti zbatues: | OJQ DYVÓ |
| Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website): | Rr. Agim Ramadani 34/19, 10000, Prishtina<br>dyvolab.rks@gmail.com<br>+383 49 211 289<br>https://www.dyvolab.com/blogs/community-1 |
| Kohëzgjatja e grantit: | Data e fillimit: 02/08/2021<br>Data e përfundimit: 31/10/2022 |
| Buxheti total i grantit (EUR): | 14,445.00 EUR |
| Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR): | 14,445.00 EUR |
| Grupet e synuara: | Aktivistë dhe dizajnerë të rinj ambientalist; Akademikë & Ekspertë nga shoqëria civile (Inxhinierë të mjedisit, Arkitektë, Dizajnerë, Sipërmarrës social); Artistë dhe aktivistë kulturorë; OShC -të; Ministria e Mjedisit & Ekonomisë; Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Komuna e Prishtinës dhe departamentet përkatëse. |
| Shtrirja gjeografike: | Prishtinë |
| Përmbledhje e grantit: | OJQ Dyvó është platformë kreative ndërdiciplinare e udhëhequr nga të rinjtë, me objektivin e forcimit të komunitetit të aktivistëve të oreintuar në problem-zgjidhje të cilët bashkëpunojnë në shkëmbimin e informacioneve, projektimin e zgjidhjeve për mirëqenie dhe avokimin e këtyre zgjidhjeve me institucionet vendore dhe kombëtare.<br>Organizata jonë ka krijuar një program praktik me bazë në komunitet për të përmbushur hendekun e magët të krijuar nga njohuritë teorike dhe mungesa e veprimeve praktike. Në programin tonë 15 mujor do të hulumtojmë, konceptojmë ide dhe do të zbatojmë projekte për të zhvilluar zgjidhje të kuptueshme dhe të replikueshme për sfidat reale shoqërore dhe mjedisore. Qëllimi jonë është të ofrojmë një hapësirë gjithëpërfshirëse të punëtorive për aktivitete edukative |

Bashkëfinancuar nga:

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

| | |
|---|---|
| | joformale dhe praktike për të rinjtë në Kosovë. Përmes programit tonë do të shfrytëzojmë potencialin e të rinjve dhe do ta transformojmë atë në qytetari aktive, kështu që përfitimi zgjerohet për të gjithë komunitetin si dhe për institucionet publike për t'i shërbyer më mirë qytetarëve, duke mbështetur kështu një ofrim më demokratik të shërbimeve publike.<br>Krahas ndryshimeve afatgjata që duam të arrijmë, duhet të zbatojmë edhe përmirësime të brendshme. Specifikisht, na duhet të krijojmë dhe forcojmë punën tonë duke:<br>• Zhvillimi i Strategjisë së Qëndrueshmërisë organizative pesëvjeçare,<br>• Strategji të PR,<br>• Avancimin e mjeteve të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave,<br>• Kapacitetet menaxhuese duke përdorur softuerë bashkëpunues,<br>• Kapacitetet teknologjike dhe të informacionit, si dhe<br>• Pajisjet dhe furnizimet të cilat janë thelbësore për hapësirën e Punëtorisë të implementojë programim e aktivizmit tonë në rajonet e Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit. |